



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

Datë: 30.04.2013  
Nr. 0204-572

**PËR:** Qemajl Mustafa, Kryetar i Komunës së Gjilanit  
Izmi Zeka, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjilanit

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË GJILANIT,**  
**01Nr.16-35599, Pranuar me datë, 25.04.2013.**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01Nr.16-35599, të miratuar me datë 23.04.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr.16-35599, për Shpalljen e Qëllimit të Ligjshëm Publik për Shpronësimin e një pjese të Ngastrave Kadastrale P-70403065-00046-1 dhe P-70403065-00045-0 në sipërfaqe 6923m<sup>2</sup>, ZK-Shurdhan për nevoja të ndërtimit të objektit të F.Sh."Bajram Curri" në fsh. Shurdhan.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,-së**

**Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së**  
**Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së**  
**Arkivit të MAPL-së.**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 30.04.2013  
br. 0204-572

**Za: Qemajl Mustafa, Gradonačelnik opštine Gnjilane**  
**Izmi Zeka, Predsedavajući Skupštine opštine Gnjilane**

**Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Gnjilane , 01br.16-35599, primljeno dana , 25.04.2013.**

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01br.16-35599, odobreno dana 23.04.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

Odluka 01 br.16-35599, o objavljivanju javnog zakonskog cilja za eksproprijaciju katastarske parcele P-70403065-00046-1 i P-70403065-00045-0 površine od 6923m<sup>2</sup> , ZK-Shurdhan za izgradnju objekta F.Sh."Bajram Curri" u selo . Shurdhan.

Sa poštovanjem,


**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a**  
**Rukovodiocima odeljenja MALS-a**  
**Arhivi MALS-a.**

25.04.2013  
0204-572



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE - MUNICIPAL GJILAN - GILAN BELEDIYESI



Duke u bazuar në nenin 11 dhe 12 të LVL, nenin 4 paragrafi 2.4.3.2 i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Ligji Nr.03/L-139), nenin 38, paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, në harmoni me Strategjinë e Zhvillimit të Komunës në sferën e arsimit, pas kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-252/13 dhe me Rekomandimin e Komitetit për Pronë, Kadastër dhe Banim me nr.01-32/2013 të dt.10.04.2013, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 23.04.2013 miraton këtë :

## V E N D I M

Për shpalljen e Qëllimit të Ligjshëm Publik për shpronësimin e një pjese të ngastrave kadastrale P-70403065-00046-1 dhe P-70403065-00045-0 në sipërfaqe prej 6923 m<sup>2</sup>, ZK-Shurdhan për nevoja të ndërtimit të objektit të Sh.F."Bajram Curri" në fsh.Shurdhan

### I

Me këtë Vendim, Komuna e Gjilanit Shpallë Qëllimin e Ligjshëm Publik për shpronësimin e pjesës së sipërfaqes nga ngastrat kadastrale : P-70403065-00046-1, Zona kadastrale -Shurdhan, lloji i njësisë-parcelë, lloji i pronës - private, zona -rurale, me sipërfaqe prej 10793 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur "Ara e Domit", shfrytëzimi aktual i parcelës - arë, klasa e kualitetit arë e klasit të 5 -të. Nga kjo parcelë shpronësohet sipërfaqja prej 5326 m<sup>2</sup>, si dhe ngastra kadastrale P-70403065-00045-0, Zona Kadastrale-Shurdhan, lloji i njësisë-parcelë, lloji i pronës-private, zona -rurale, me sipërfaqe prej 4087 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur "Ara e Domit", shfrytëzimi aktual i parcelës- livadh, klasa e kualitetit - livadh i klasës së 7-të. Nga kjo parcelë shpronësohet sipërfaqja prej 1597 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e cila duhet të shpronësohet nga të dy këto ngastra është 6923 m<sup>2</sup> dhe do të shërbej për ndërtimin objektin publik i cili i nevojitet Drejtorisë Komunale të Arsimit për ofrimin shërbimeve arsimore përmes Shkollës Fillore "Bajram Curri" në fshatin Shurdhan. Këto ngastra evidentohen në emër të bashkëpronarëve me nga 1/3 e pjesës së pronës : Bashkim (Maliq) Aliu, Hamit (Maliq) Aliu dhe Florim (Avdi) Aliu që të tre nga fsh.Shurdhan, Komuna e Gjilanit

### II

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që ta bënë parcelimin e pjesës së sipërfaqeve e cila duhet të shpronësohet (sipërfaqja 6923 m<sup>2</sup>) dhe pasë parcelimit të këtyre ngastrave të krijohen ngastrat e reja : 46-3 me sipërfaqe prej 5326 m<sup>2</sup>, dhe ngastra nr.45-1 me sipërfaqe 1597 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e përgjithshme e të dy parcelave është 6923 m<sup>2</sup>, në mënyrë që pjesa tjetër e cila nuk shpronësohet të mbetet e lire për shfrytëzim nga ana e bashkëpronarëve të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

### III

Obligohet Organi Shpronësues që në afatin sa më të shkurtër kohorë për sipërfaqen (6923 m<sup>2</sup>) të rekomanduar nga Komiteti për Pronë dhe Banim dhe Komiteti për Politikë dhe Financa të përfundoj procedurat e vlerësimit dhe shpronësimit në mënyrë që parcela e lartë përmendur të kalojë në pronësi të Drejtorisë Komunale të Arsimit - shkollës fillore "Bajram Curri" në fshatin Shurdhan.

### IV

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që pas përfundimit të procedurave të shpronësimit dhe vlerësimit të pronës nga Zyra për Vlerësimin e Paluajtshmërive pran Departamentit të Tatimit në Pronë në kuadër të MEF, të kryej obligimet financiare ndaj pronarit të parcelës që ka sipërfaqen prej (6923 m<sup>2</sup>)

### V

Obligohet Drejtoria e Arsimit të bashkëpunoj ngushtë me donatorin (Zyrën e Komisionit Evropian në Kosovë dhe Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal) dhe ti njoftoj mbi përmbylljen e procedurave të shpronësimeve të parcelës si dhe të jetë institucion garantues se nuk do të ketë asnjë problem në realizimin projektit : Ndërtimi shkollës fillore "Bajram Curri" në fshatin Shurdhan.

### VI

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike që ta pajisë objektin me pëlqim dhe leje urbanistike, si dhe të lejojë e siguroj kyçje në rrjetin e infrastrukturës publike (ujësjellës, kanalizim, rrymë)

### VII

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike të KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

### VIII


Pas aprovimit të këtij vendimi obligohet sekretaria e kuvendit ta njoftoj Zyrën e Komisionit Evropian në Kosovë dhe Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe drejtoritë përkatëse komunale për zbatimin e këtij vendimi .

### IX

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit

Nr.01-16-35599

Gjilan, më 23-04-2013



Kuvendi i Komunës  
*[Signature]*  
/Izini ZEKA, Kryesues/